

VENDIM
Nr.304, datë 6.4.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR
SHPËRBLIMIN E LOJTARËVE DHE TË TRAJNERIT TË EKIPIT KOMBËTAR TË
FUTBOLLIT, PËR REZULTATIN E ARRITUR DHE NIVELIN E LARTË SPORTIV TË
TREGUAR NË NDESHJEN KUALIFIKUESE TË KAMPIONATIT EUROPIAN 2012,
SHQIPËRI-BJELLORUSI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në buxhetin e miratuar për vitin 3011, në programin “Zhvillimi i sportit”, t’i shtohet kundërvlefë në lekë e fondit prej 225 000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) eurosh, për shpërblimin e lojtarëve të ekipit kombëtar dhe të trajnerit të tij, z.Josip Kuze, për rezultatin e arritur dhe nivelin e lartë sportiv të treguar në ndeshjen kualifikuese të Kampionatit Europian 2012, Shqipëri-Bjellorusi, zhvilluar në datën 26 mars 2011, sipas preventivit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha